



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:132331

Datë: 21.10.2024

Numri i dokumentit: 06327721

KPPP.nr. 782/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit Inspektorati Farmaceutik me seli në Prishtinë, Instituti B, kati përdhësë, rrethi i QKUK-së, kundër debitorit B.F., person përgjegjës në barnatoren "Bashkimi", me numër të biznesit 810566797 dhe me seli në Mitrovicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Eris Hana, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 230/24, i lejuar me datë 23.02.2024, nga Përbaruesi Privat Ilmi Miftaraj, me seli në Mitrovicë, jashtë seancës me datën 21.10.2024, merr këtë:

#### A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur sipas prapësimit të debitorit B.F., të ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 230/24, i lejuar me datë 23.02.2024, nga Përbaruesi Privat Ilmi Miftaraj.
- II. Pas plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi, lënda se bashku me shkresat e saj i dërgohen Departamentit të Përgjithshëm pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

#### A r s y e t i m

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës KPPP.nr. 782/24 në çështjen përbarimore të kreditorit Inspektorati Farmaceutik, kundër debitorit B.F. me adresë në Mitrovicë, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës dhe gjeti se Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje

Ekonomike pranë Gjykatës Komerciale nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas prapësimit lidhur me këtë çështje.

Meqenëse në rastin konkret çështja përmbartimore zhvillohet në mes të kreditorit si person juridik dhe debitorit si person fizik, lidhur me kërkesën për pagesën e borxhit mbi bazën e vendimit të organit administrativ, ndërsa me nenin 13, paragrafi 1, pik 1.1 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: *“kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*, ndërsa me pikën 1.2 të të njëjtit nen, përcaktohet se: *“të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbartimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*, rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate për vendosje, pasi që në rastin konkret në cilësinë e kreditorit është personi juridik, ndërsa në cilësinë e debitorit është paraqitur personi fizik. Për më tepër, edhe vendimi i organit administrativ objekt përmbartimor është marr ndaj debitorit B.F. si person fizik.

Ndërsa, nisur nga fakti se adresa e debitorit të përmbartimit është në Mitrovicë, në mbështetje të nenin 12 dhe 20 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykata dhe nenin 5 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L139 për Procedurën Përmbartimore i cili përcakton se *“Për të vendosur çështjet që kanë të bëjnë me çdo prapësim, ankesë, parregullsi në procedurën përmbartuese sipas nenit 52 dhe 67 të këtij ligji, ose çfarëdo lloj procedure kundër veprimeve të ndërmarra nga Përmbartuesi privat, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës debitori ka vendbanimin apo nëse nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë në territorin në të cilin ka vendqëndrimin nëse është person fizik. Nëse debitori është person juridik, kompetencë territoriale ka Gjykata kompetente ku gjendet selia e debitorit. Nëse debitori nuk ka vendbanim të përkohshëm ose seli në Kosovë, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e se cilës gjinden sendet e luajtshme dhe të paluajtshme e të cilat janë objekt përmbartimi”*, kjo gjykatë vlerëson se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 17 dhe 19 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 782/24, datë 21.10.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.